



Informacione mbi udhëtimin e kthimit nga një zonë rreziku

Njerëzit që kthehen nga një zonë rreziku dhe që jetojnë në rrethin Heilbronn, janë të detyruar të raportojnë pranë Zyrës së Rendit Publik Heilbronn menjëherë pasi të hyjnë përsëri në Gjermani dhe të vetëkarantinohen direkt në shtëpi ose në një akomodim tjetër të përshtatshëm. Karantina duhet të zgjatë për një periudhë 14 ditore. Gjatë kësaj kohe nuk mund të pranohen vizitorë, të cilët nuk banojnë në shtëpinë tuaj.

Në linkun e mëposhtëm mund të shikoni se cilat vende konsiderohen zona rreziku:

https://www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Risikogebiete_neu.html

Ju nuk duhet të hyni në karantinë, nëse i përkisni një grupi të caktuar profesional ose nëse paraqisni një raport mjekësor në gjermanisht ose anglisht pranë Zyrës së Rendit Publik. Raporti mjekësor duhet t'i

- referohet një testi për Coronën (test biologjik molekular),
- i realizuar në një [shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose në një shtet tjetër të botuar nga instituti Robert-Koch dhe](#)
- të jetë bërë jo më shumë se 48 orë para hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë.

Për informacione të mëtejshme ju lutem referojuni rregullores për Coronën, karantina pas kthimit tek Ministria e Çështjeve Sociale e Baden-Württemberg: <https://www.baden-wuerttemberg.de/de/service/aktuelle-infos-zu-corona/verordnung-fuer-ein-und-rueckreisende/>. Në seksionin § 2, renditen grupet profesionale të cilat nuk duhet të karantinohen.

Si ta raportoj kthimin tim në Zyrën e Rendit Publik Heilbronn?

Raporti në Zyrën e Rendit Publik duhet të bëhet me shkrim në adresën e emailit

veranstaltungen@heilbronn.de. Çdo person që ka udhëtuar dhe banon në rrethin Heilbronn, duhet të raportojë me e-mail tek Zyra e Rendit Publik dhe të përfshijë informacionet e mëposhtme:

1. Emri dhe mbiemri
2. Datëlindja
3. Adresa në Heilbronn
4. Të dhënat e kontaktit (adresë e-maili ose numër telefoni)
5. Aktiviteti profesional dhe punëdhënësi
6. Data e kthimit
7. vendi nga i cili jeni kthyer
8. Arsyeja e qëndrimit jashtë vendit
9. gjendja shëndetësore

Informacione të mëtejshme mund të merrni në www.heilbronn.de/coronavirus nën titullin rregullorja për udhëtimin dhe kthimin.